



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:280606

Datë: 07.10.2020

Numri i dokumentit: 01226836

P.nr.1334/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zytare ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit I.A., për shkak të veprës penale vjedhje pyllit në vazhdim nga neni 349 par. 1 dhe neni 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) duke vepruar sipas Aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2091-9/19 dhe PP/II.nr.2090-9/2019, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur më datë 23.09.2020, në prani të prokurorit të shtetit Besnik Nuredini, të pandehurit dhe Përfaqësuesit të DBP-Ferizaj Liridon Jetishi, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datën 07.10.2020, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri I.A., nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur me dt.në fshatin K Ferizaj , ku dhe tani jeton, me numër personal të lejes së njoftimit, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar edhe më parë për vepër penale vjedhje pylli, ndaj tij udhëhiqet procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

1.Me datën 12.10.2019, rreth orës 17:00, në rajonin ekonomik-pyJOR Neredime-Jezerc, saktësisht në vendin e quajtur “Firishta”, me qëllim të vjedhjes me sharrë motorike ka prerë dy lisa të njom të llojit ahu, me diametër 45-50 cm, me lartësi Boniteti III, me vëllim të përgjithshëm 3.31 m³, me ç’rast Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 446.85 €.

2. Me datën 13.08.2019, rreth orës 16:30, në rajonin ekonomik-pyJOR Neredime-Jezerc, saktësisht në vendin e quajtur “Firishta”, me qëllim të vjedhjes me sharrë motorike ka prerë tre lisa të njom të llojit ahu, me diametër 38-45 cm, me lartësi Boniteti III, me vëllim të përgjithshëm 3.34 m³, me ç’rast Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 450.90 €.

Me çka ka kryer vepër penale vjedhje pylli në vazhdim nga neni 349 par. 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21,38,39,40, 43,69,70, dhe 349 të KPRK-së si dhe nenit 365,453,463 të KPPK-së, të pandehurin e:

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 300€/treqind euro/, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 /tridhjetë/ ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t’i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

I pandehuri konform nenit 463 par. 2 të KPPK-së, obligohet që Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari të komunës së Ferizajt, të ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumë prej 897.75 €, në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë/, në afatin prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Poashtu i pandehuri obligohet, konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat PP/II.nr.2091-9/19 dhe PP/II.nr.2090-9/2019 , ka akuzuar të pandehurin për shkak të veprave penale vjedhje pylli nga neni 349 par. 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjeve penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështjet janë në juridiksionin e saj dhe gjykimi i këtyre çështjeve penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi veprat penale që janë për proceduar pët të pandehurin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku janë kryer ose tentohet të kryhen veprat penale.

Gjykata duke vepruar në çështjet penale caktoi dhe mbajti seancen e shqyrtimit fillestar me dt.23.09.2020 në të cilin shqyrtim kanë marrë pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri dhe Përfaqësuesi i DBP-Ferizaj Liridon Jetishi.

Gjykata pasi ka vërejtur se ndaj të pandehurit janë paraqitur dy aktakuza nga prokuroria e shtetit dhe veprat penale në to janë të natyrës së njëjtë, objekti i njëjtë, dashja e njëjtë dhe janë kryer në intervale kohore të përafërta, për shkaqe të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, pas marrjes së mendimit dhe pëlqimit të palëve lidhur me bashkim të procedurave

penale, në kuptim të nenit 35 të KPPK-së, vendosi për bashkimin e lëndëve penale P.nr.1334/19 me numër të aktakuzës PP/II.nr.2091-9/19 dhe lëndës P.nr.1340/19 me aktakuzën numër PP/II.nr.2090-9/19 , kundër të pandehurit për shkak të veprave penale vjedhje pylli nga neni 349 par. 1 të KPRK-së, dhe në të ardhmen procedura penale për këto dy lëndë do të udhëhiqet me numrin më të vogël të lëndës P.nr. 1334/19 .

Në fillim të shqyrtimit fillestar në mbështetje të nenit 245 par. 2 të KPPRK-së , gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i pandehuri në mënyrë të rregullt ka pranuar kopjet e aktakuzave nga ana e Prokurorisë Themelore në Ferizaj si dhe ka konstatuar se janë plotësuar detyrimet lidhur me zbulimin e provave të parapara në nenin 245 par. 4 të KPPRK-së.

Gjykata më tej ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 246 par. 1 të KPPRK-së dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim të nenit 246 par. 3 të KPPRK-së, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzave nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar në tërësi aktakuzat, konform nenit 246 par.4 të KPPRK-së, të pandehurit i ka afruar mundësin që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë e tij për veprat penale për të cilat është akuzuar.

I pandehuri I.A. në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë sipas aktakuzave për të gjitha pikat e tyre dhe ka shtuar se ndihem i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të më vijnë, kam shkuar në pyll të marr dru pa leje për shkak të gjendjes shumë të dobët ekonomike që e kam në familje, po premtoj se në të ardhmen do të mundohem që më të mos e përsëris kësi vepra penale pasi punoj nga pak kur gjej ndonjë punë, andaj lus gjykatën që të merr parasysh gjendjen e dobët ekonomike që e kam me rastin e shqiptimit të dënimit.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar në pajtim me nenin 248 par. 2 të KPPRK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe të përfaqësuesit të DBP .

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaron: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri meqë një pranim i tillë është bërë konform dispozitave ligjore nga neni 248 të KPPK-së, pra në mënyrë vullnetare, e i cili pranim ka mbështetur në të gjitha provat dhe shkresat që përmbajnë aktakuzat, i propozoj gjykatës që ta këtë parasysh pranimin e fajësisë.

Përfaqësuesi i DBP pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit deklaron se: i bashkangjitem ndjekjes penale dhe poashtu paraqes kërkesë pasurore –juridike për dënim që na e ka shkaktuar i pandehuri.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par.1 nën.par.1 dhe par.4 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rasteve konkrete dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit dhe atë për akuzën e parë: fletparaqitja e rojës së pyjeve nr.425/19, e dt. 20.10.2019, procesverbali i DBP në Ferizaj, nr.425/19 i dt.28.10.2019, dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë. Ndërsa për akuzën e dytë fletparaqitja e rojës së pyjeve nr.423/19, e dt. 28.10.2019, procesverbali i DBP në Ferizaj, nr.423/19 i dt.28.10.2019, dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit për të dy rastet ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje e pyllit nga

neni 349 par.1 të KPRK-së,të kryer në vazhdimësi , të cilat janë të përshkruara më hollësisht si në dispozitive të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprave penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siq është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për çka dhe i pandehuri u shpall fajtor dhe ju shqiptua dënim siq është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprat penale të kryera dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej kësi lloj vepra penale apo të ngjashme, gjendjen e dobët ekonomike të tij, ndërsa në rastin konkret si rrethanë rënduese gjeti se i pandehuri sipas deklaramit të tij edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale të njëjta si dhe vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprave penale, rrezikshmërisë dhe të autorit të tyre, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi obligimin e të pandehurit për pagesën e dëmit palës së dëmtuar është marrë në kuptim të nenit 463 par. 2 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par.2, pika 2.1 dhe 2.6. lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,

P.nr.1334/19 e dt.07.10.2020

Zyrtare ligjore:

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Kimete Bytyqi

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe Gjykatën.